



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 2857 / Prot.

Pogradec, më 23 . 06 . 2022

VENDIM

NR. 58 , DATË 22 . 06 . 2022

PËR  
MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT  
PYJOR/KULLOSOR, PËR QËLLIME "AGROPYLLTARIE" ME  
LOKACION "GURËT E GJETË".

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/c, nenit 27 pika 5 nenit 54 pika "e" të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr.8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", Ligjit Nr.57/2020, "Për pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr.433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1064, datë 22.12.2010, në zbatim të Urdhërit Nr.74 datë 03.06.2022 nga Drejtori i Ndërmarrjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike "Për hartimin e Raportit Tekniko – Ekonomik për marrjen e sipërfaqes pyjore me qera/përdorim në ekonomine pyjore Moker 1", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë, dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, për qëllime "Agropylltarie" me emër lokal "Gurët e gjetë", me sipërfaqe 8.8 ha në zonën kadastrale nr.2949 me nr.pasurie 220/1 për afat përdorimi 9 vjet.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", *Sipërfaqja e marrë në studim do të nënshtrohet* procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë, pasi të hyjë në fuqi Vendimi i Këshillit Bashkiak, si dhe konfirmimi i Prefektit të Qarkut Korçë.



4. Çdo subjekt, të kryejë aktivitetin në sipërfaqet e miratuara vetëm mbas nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimit të sipërfaqes me procesverbal dorëzimi nga struktura e Shërbimit Pyjor.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit, Shërbimi Pyjor dhe Drejtoria Juridike, Sektori i evidentimit dhe inventarizimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
7. U shpall sot më datë 22.06.2022

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

